

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trump premton 5 mijë dollarë për çdo amerikan, ish-ministri ironizon PD: Nëse do e bënte Rama këtë në Shqipëri, SHQUP-i do e kthente në alarm kombëtar
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/trump-premton-5-mije-dollare-per-cdo-amerikan-ish-ministri-ironizon-pd--i401002
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 15:38:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 15:34:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f2727e1cab64b5842d52afb8c78c32a7ba894109f28be019d2b2c2fdf59167a5
TEKSTI	062ebe965d80b783e1c045b92a1caa0a9973c89feb1e37fea66f4f5f23833207
PAMJA	17724b1a26433bb91456276bb0e9a6ee2b040ef7d67b5eb1332e0efa756e4825

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4de5eab50e9a6deb48913fe58c04287e024a264c86edc27838f82aea71d09d65
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ab892af2d9e792fa00a607397de5c726b18c8487fd3face12e7f3de998a653a0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/4de5eab50e9a6deb48913fe58c04287e024a264c86edc27838f82aea71d09d65

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Politikë

11 Shtator 2026, 17:34

Trump premton 5 mijë dollarë për çdo amerikan, ish-ministri ironizon PD: Nëse do e bënte Rama këtë në Shqipëri, SHQUP-i do e kthente në alarm kombëtar

Shkruar nga Newsbomb



Foto ilustrim: Selia e PD-së dhe Ylli Manjani

Ish-ministri Ylli Manjani ka reaguar në lidhje me premtimin që presidenti i SHBA-së Donald Trump bëri në prag të zgjedhjeve të mesmandatit, ku sipas tij nëse Partia Republikane do të fitojë garën.

Manjani shkruan se nëse Rama do ta bënte diçka të tillë në vendin tonë, PD-ja do të shpërthente alarmin kombëtar ndërsa OSBE/ODIHR do nxirrte deklaratë për "cenimin e barazisë së garës".

"SPAK-u do regjistronte procedim penal për korrupsion aktiv zgjedhor në formën e premtimit elektoral. Analistët do flisnin për "blerje masive votash", ndërsa televizionet do hapnin kronikat me muzikë suspense", shkruan ai.

Po ashtu ish-ministri shkruan në rrjetet sociale, se roli i OSBE-së në zgjedhjet në vendet e tjera, nuk ka të njëjtin fuqi dhe rol si në Shqipëri.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

Kryepolici Skënder Hita takim me strukturat e Policisë në Korçë, Tiranë dhe Dibër. Godisni grupet kriminale dhe ndaloni ata që lëvizin me armë e drogë



Rajoni

Vuçiq del me DATE: Do e jap dorëheqjen sapo të kthehem nga Nju Jorku

Zbuloj më shumë artikuj >

"Prandaj, kot për muhabet, më duket se ne kemi bërë një gabim të madh mesa duket: kemi tentuar të ndërtojmë një demokraci më demokratike se demokracia. Ose demokracia ka vajtur për shëlle... Me më shumë OSBE, më shumë ODIHR, më shumë raporte, më shumë standarde, më shumë moral", shkruan ai,

Postimi i plotë:

Ka ca lajme që, po të ndodhnin në Shqipëri, nuk do ishin më lajme. Do ishin dosje penale.

Donald Trump del publikisht dhe premtun: 5,000 dollarë për çdo amerikan, nëse fiton partia e tij në zgjedhjet e nëntorit.

Imagjinoni tani të njëjtën fjalë në shqip.

"Edi Rama premtun 5,000 euro për çdo shqiptar nëse fiton PS."

Nuk do kalonin pesë minuta. Nga SHQUP-i do shpërthente alarmi kombëtar. OSBE/ODIHR do nxirrte deklaratë për "cenimin e barazisë së garës". SPAK-u do regjistronte procedim penal për korrupsion aktiv zgjedhor në formën e premtimit elektoral. Analistët do flisnin për "blerje masive votash", ndërsa televizionet do hapnin kronikat me muzikë suspense.

Sepse kështu na mëson ligji ynë penal. Premtimi i një përfitimi material për të ndikuar votën është histori serioze.

Po në Amerikë?

Në Amerikë nuk diskutohet nëse është normale të premtosh para. Diskutohet vetëm nga do t'i gjejë paratë.

Pra problemi nuk është premtimi. Problemi është Excel-i.

Më lind një pyetje krejt naive: A ka OSBE/ODIHR në Amerikë?

Apo OSBE-ja është një organizatë që ekziston vetëm për vendet ku demokracia është ende "në zhvillim", ndërsa kur bëhet fjalë për superfuqinë, demokracia hyn në kategorinë "vetërregullohet"?

Ndoshta amerikanët kanë një version tjetër të manualit.

Tek ne quhet "premtim elektoral me elemente korrupsioni". Atje quhet "tax rebate", "dividend", "bonus", "stimulus", "refund". Mjafton ta përkthesh në anglisht dhe neni penal humbet në oqean.

Madje nuk është as risi. Amerika e Joe Biden shpërndau miliarda dollarë gjatë pandemisë. Atëherë u quajt stimul ekonomik. Sot Trump premtun dollarë në fushatë. Quhet politikë fiskale.

Sa elegante tingëllojnë fjalët kur vijnë me pasaportë amerikane.

Edhe më interesante është heshtja mediatike. Po të ishte Shqipëria, do kishim tre javë studio televizive me titull "A po blihet vota?". Në SHBA debati është krejt tjetër: "A është e realizueshme financiarisht?"

Askush nuk pyet nëse është e pranueshme demokratikisht t'i thuash zgjedhësit: voto dhe do marrësh para.

Mesa duket, demokracia ka edhe kurs këmbimi.

Një standard për ata që monitorohen dhe një standard për ata që monitorojnë.

Prandaj, kot për muhabet, më duket se ne kemi bërë një gabim të madh mesa duket: kemi tentuar të ndërtojmë një demokraci më demokratike se demokracia. Ose demokracia ka vajtur për shëlle... Me më shumë OSBE, më shumë ODIHR, më shumë raporte, më shumë standarde, më shumë moral.

Ndërkohë, në vendin që na jep leksione për zgjedhjet, fushata mund të vijë edhe me ofertë propagandale.

Ori te promovuarë.

"Voto dhe merr 5,000 dollarë."

Ndoshta sekreti është i thjeshtë.

OSBE/ODIHR nuk mungon në Amerikë.

Thjesht... nuk monitoron amerikanët.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Premte 16:37

10 milionë në muaj rrogë, Edi Rama u pret hovin gjyqtarëve dhe prokurorëve: Dyert e Thesarit të Shtetit i hap vetëm Kuvendi



Politikë

5 vjet nga përjashtimi i Sali Berishës nga PD, kur Ambasada Amerikane i bënte jehonë vendimit të Lulzim Bashës dhe udhëtimi i parë i liderit demokrat në SHBA

🕒 E Premte 15:04




Politikë

Protestuesit i kërkojnë në shesh, Rama pret në Kryeministri studentët e rinj: Fakti që jeni këtu do të thotë se nuk dëgjoni nga ai vesh, jeni frymëzim!

🕒 E Premte 14:54 Newsbomb





E Premte 14:02

Nga Kuvendi zyrtarisht te Shëndetësia, ministrja Spahiu tregon prioritetet: Transformoj sistemin



Politikë

"Më vjen ndot", ministrja Erjona Ismaili e sfidoi për të ardhur në Shqipëri, Arben Ahmetaj e injoron nga arratia: Kush është kjo? E njihni ju, se unë jo (REAGIMI)

E Premte 13:10



Politikë

Nga sot pjesë e stafit në Kryeministri, Besfort Lamallari reagon pas lirimt si ministër: Ka qenë nder për mua, tani do t'ia kthej Ramës besimin që pati

E Premte 13:03



E Premte 12:35

Rama e bëri sot ministër të Brendshëm, Gazment Bardhi zbulon lidhjen e Ervin Demos me kreun e SPAK: Braho të distancohet



Politikë

Politologu i njohur kritikon reagimin e Ramës dhe Demos pas propozimit për ministër: Emërimi kalon nga Presidenti dhe Kuvendi

E Premte 12:00



Politikë

"Prania Besnike" e socialistëve vihet në praktikë duke filluar nga SOT, do të marrin pjesë edhe ministrat

E Premte 11:57





🕒 E Premte 11:32

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.